

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për krime të rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Syzana Goxhuli, si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarve B.I., L.K. dhe E.D., për shkak të veprave penale në bashkëkryerje Sulmi nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-se dhe veprës penale në bashkëkryerje Lëndimi i lehte trupor nga neni 188 par.1 nen.par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-se, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.422/15 të datës 30.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **08. Shkurt. 2019**, mori këtë:

AKTGJYKIM

REFUZOHET si e **pabazuar** ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.422/2015 të datës 30.11.2018, **VËRTETOHET**.

Arsyetim

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë PRK.nr.422/15 të datës 30.11.2018 të akuzuarit L.K. dhe E.D. janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale në bashkëkryerje sulmi nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-se për të cilën iu është shqiptuar secilit veç e veç dënimi me gjobe në shume prej nga 300 Euro e të cilat gjoba janë të obliguar që ti paguajnë në afat prej 15 ditësh por jo më gjatë se 3 muaj pasi që ky aktgjykim të merr formën e prere.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet i njëjti do të shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro do të iu llogaritet një ditë burg.

Te akuzuarit janë obliguar që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale që dalin sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës si dhe paushallin gjyqësore secili veç e veç nga 30 Euro dhe për fondin e kompensimit të viktimat të krimit shumen prej 50 Euro në afat prej 15 ditësh por jo më gjatë se 3 muaj pasi që ky aktgjykim të merr formën e prere.

Te dëmtuarit A.S. dhe B.B. për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Me të njëjtin aktgjykim ndaj të akuzuarve B.I., L.K. dhe E.D., në bazë të nenit 363 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së është refuzuar akuza për shkak të parashkrimit absolut të

ndjekjes penale, për shkak te veprës penale ne bashkëkryerje Lëndimi i lehte trupor nga neni 188 par.1 nen.par.1.4 lidhur me nenin 31 te KPRK-se.

Gjithashtu është vendosur që shpenzimet e procedurës penale lidhur me këtë çështje penale të bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.

I dëmtuari F.B. për realizimin e kërkesës pasuror-juridike është udhëzuar ne kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Prishtine, për shkak të shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës penale dhe shkeljes se ligjit penal, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtine ta anuloj dhe çështjen te ja kthej Gjykatës se shkalles se pare ne rigjykim dhe vendosje.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u skjaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtine , me shkresën e vet PPA.I.nr.40/19 të datës 18.01.2019 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtine ta aprovoj si të bazuar, ashtu që aktgjykimin e atakuar ta anuloj dhe çështjen t'ia kthej Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje

Gjykata e Apelit e Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPRK-së shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, si dhe pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Prishtine, dhe gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Sipas ankesës së Prokurorisë Themelore ne Prishtine aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale në kuptim të nenit 384 par.1 nënpar.1. 12 e lidhur me nenin 370 par.7 te KPRK-se për faktin se Gjykata e shkalles se pare e ka refuzuar akuzën ndaj te akuzuarve B.I., L.K. dhe E.D. me arsyetim se me date 15.11.2017 ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për shkak te veprës penale ne bashkëkryerje Lëndimi i lehte trupor nga neni 188 par.1 nen.par.1.4 e lidhur me nenin 31 te KPRK-se vetëm duke u bazuar ne kualifikimin juridik te veprës penale pa u bazuar ne përmbajtjen e dispozitivit te aktakuzës ku janë te përshkruara veprimet e te akuzuarit B.I. i cili me qellim te shkaktimit te lëndimit trupor, e ka goditur te dëmtuarin, me çrast Gjykata e shkalles se pare e ka shkelur edhe ligjin penal ne favor të të akuzuarve kur ka refuzuar aktakuzën për shkak te parashkrimit absolut te ndjekjes penale edhe pse nga përmbajtja e dispozitivit te aktakuzës ekzistojnë elementet e veprës penale për te cilën nuk ka arritur parashkrimi i ndjekjes penale respektivisht elementet e ndjekjes penale nga neni 188 par.2 te KPRK-se.

Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se pretendimet e mësipërme ankimore te Prokurorisë Themelore ne Prishtine lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk qëndrojnë. Aktgjykimi i ankimuar është i qartë dhe konkret, nuk përmban kundërthënie qoftë me vetveten ose me arsyetimin e tij. Në arsyetim janë dhënë arsye të

duhura faktike dhe juridike mbi të gjitha faktet relevante. Gjykata e shkallës së parë vlerësimin e provave e ka bërë në harmoni me nenin 370 të KPPRK-së, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i merr si të provuara ose të pa provuara. Gjykata e shkallës së parë ka bërë analizimin e provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në bazë të tyre ka nxjerre konkludimet e veta të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Gjithashtu, nuk ekzistojnë as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nga aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Prishtine PP.I.nr.1105/13 e datës 20.07.2015 shifet se te akuzuarit B.I., L.K. dhe E.D. janë akuzuar për veprën penale ne bashkëkryerje Sulmi nga neni 187 par.1 lidhur me nenin 31 te KPRK-se për te cilën te akuzuarit L.K. dhe E.D. janë shpallur Fajtor dhe janë dënuar me gjobe ndërsa ndaj te akuzuarit B.I. është veçuar procedura me aktvendim ngase i njëjti gjendet jashtë Kosovës.

Po me te njëjtën aktakuzë te akuzuarit B.I., L.K. dhe E.D. janë akuzuar për veprën penale ne bashkëkryerje Lëndimi i lehte trupor nga neni 188 par.1 nen.par.1.4 lidhur me nenin 31 KPRK-se, për te cilën Gjykata e ka refuzuar akuzën me arsyetim se me datën 05.11.2017 ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Gjykata e Apelit konstaton se nuk janë te bazuara pretendimet e Prokurorisë Themelore ne Prishtine lidhur me shkeljen e ligjit penal ngase nga aktakuza e cila gjendet ne shkresat e lendes shifet se te akuzuarit e lartcekur janë te akuzuar nga ana e Prokurorisë për veprën penale ne bashkëkryerje Lëndimi i lehte trupor nga neni 188 par.1 nen.para.1.4 e lidhur me nenin 31 te KPRK-se e për te cilën ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale me date 05.11.2017 dmth dyfishi i parapare për ndjekje penale për këtë vepër dhe se kjo nuk mund te konsiderohet ndonjë gabim teknik nga ana e Prokurorisë me rastin e cilësimit te veprës penale, andaj konstatohet se Gjykata e shkalles se pare drejt e ka aplikuar edhe ligjin penal kur e ka refuzuar akuzën ndaj te akuzuarve te lartcekur për shkak te parashkrimit absolut, andaj gjeti se pretendimet ankimore te Prokurorisë edhe lidhur me këtë baze ankimore nuk janë te bazuara.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.25/19, më 08.02.2019

Procesmbajtësen
Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi

Afrim Shala
